




VETEVALUIMI I SHKOLLËS FILLORE

SHFK „ASDRENI”-F. GLLOGJË KOMUNA TEARCË

për periudhën nga viti 2023/2024 deri në 2024/2025



Gusht, 2025

VETEVALUIMI I SHKOLLËS	
Shkolla	„Asdreni”
Adresa	Fshati Gllogjë, Komuna Tearcë
Telefoni,e-mail	Asdreni.shkolla@gmail.com
Periudha e pregaditjes së EVSH-së	2023/2024-2024/2025
Numri i nxënësve në shkollë	268 (2023/2024) 270 (2024/2025)
Drejtori i shkollës	
Emir dhe mbiemri	Agon Amiti
Nënshkrimi	
Data	
Aprovim nga KSH-ja	
Emri dhe mbiemri	Laureta Abduli
Nënshkrimi	
Data	

Fusha 1: Planifikimi, mësimi dhe nxënia

Treguesit e fushës:

1.1 Planifikimet e mësimdhënësve

1.2 Procesi i mësimi

1.3 Përvojat e nxënësve nga nxënia

1.4 Notimi si pjesë e mësimi

1.5 Aktivitete dhe gara jashtëshkollore

Mbledhja e të dhënave (Cilat të dhëna janë mbledhur: Cilat metoda janë përdorur). Përpunimi i dokumenteve		
Treguesi 1.1 Planet e mësimdhënësve		
Burimet e të dhënave	Temat sipas treguesve	Informacionet që janë mbledhur
Programi vjetor i punës së shkollës; planet e mësimdhënësve; listat, agjendat dhe raportet nga trajnimet e realizuara; procesverbalet dhe listat e takimeve të aktiveve profesionale; anketat me mësimdhënësit; intervistat me drejtorin, bashkëpunëtorët profesionalë; raportet nga bashkëpunëtorët profesionalë për planifikimet e ndjekura	Mbështetje dhe ndjekje të planifikimeve të mësimdhënësve	☐ Të gjitha planet mësimore të përgatitura nga mësimdhënësit për lëndët përkatëse (planifikimi i realizimit të programeve mësimore, mujore dhe ditore). ☐ Evidencat e përdorimit të planeve në orët mësimore. ☐ Dokumente që dëshmojnë ndjekjen dhe reflektimin mbi planet (procesverbale nga mbledhjet, raporte vlerësimi të brendshëm). ☐ Rezultatet e anketave me mësimdhënësit për përvojat e tyre në planifikim. ☐ Komunikimi dhe ndarja e planeve me kolegët (platforma digjitale, takime profesionale). ☐ Përshtatja e planeve me udhëzimet e Ministrisë dhe me nevojat e nxënësve.
	Shkëmbim i përvojave dhe informacioneve gjatë planifikimit	• Janë zhvilluar takime të rregullta profesionale mes mësimdhënësve për diskutimin dhe përmirësimin e planeve mësimore. • Janë mbajtur procesverbale nga takimet ku janë ndarë përvoja dhe ide të suksesshme për planifikim. • Mësimdhënësit kanë ndarë plane mësimore, modele të fletëve të punës dhe strategji mësimore përmes platformave digjitale (p.sh. Google Drive, Viber, email etj.). • Janë organizuar trajnime të brendshme ose punëtori për planifikim të integruar dhe sipas kompetencave. • Bashkëpunime ndërmjet mësuesve të klasës dhe mësuesve lëndorë për të siguruar vazhdimësi në përmbajtjen dhe metodologjinë mësimore. • Udhëheqësit e shkollës kanë inkurajuar dhe lehtësuar shkëmbimin e

		përvojave përmes axhendave mujore dhe takimeve të strukturuar.
Treguesi 1.2 Procesi i mësimit		
Burimet e të dhënave	Temat sipas treguesve	Informacionet që janë mbledhur
Programi vjetor i punës së shkollës; orari i orëve të mësimit; editari; evidenca dhe dokumentacioni pedagogjik; listat dhe raportet e trajnimeve të realizuara; procesverbalet e mbledhjeve të aktiveve profesionale; anketat me mësime të nxënësve; prindërit/kujdestarët; diskutimet në fokus grupet me nxënësve, mësime të prindërit/kujdestarët; intervistat me drejtorin, bashkëpunëtorët profesionalë; raportet nga vizitat në klasa; zgjidhjet për ekip inkluziv shkollor; përgatitja e PIA-ve dhe programeve të modifikuara për nxënësve me nevojë të veçanta arsimore; procesverbalet e mbledhjeve të ekipeve shkollorë për inkluzion dhe ekipeve inkluzive për nxënës; raportet dhe procesverbalet	Realizimi i planeve dhe programeve mësimore	- Janë hartuar planifikime vjetore dhe mujore nga të gjithë mësuesit - Programet mësimore janë zbatuar sipas kurrikulës kombëtare - Janë përdorur plane individuale për nxënës me nevojë të veçanta
	Zgjedhja e lëndëve mësimore	- Është zhvilluar procedura për përzgjedhjen e lëndëve zgjedhore - Janë organizuar takime me nxënës dhe prindërit për orientim dhe zgjedhje të lëndëve zgjedhore - Janë përpiluar lista dhe plane për lëndët zgjedhore të përzgjedhura
	Përzgjedhja e detyrave, aktiviteteve dhe burimeve	- Janë zhvilluar aktivitete praktike dhe projekte grupore - Janë përdorur mjete dhe burime të ndryshme mësimore për të përmbushur objektivat - Detyrat janë përshtatur sipas niveleve të nxënësve
	Ndërveprimi mes mësuesve dhe nxënësve dhe nxënësve me njëri-tjetrin	- Janë realizuar punë në grupe dhe projekte të përbashkëta - Është inkurajuar puna bashkëpunuese ndërmjet nxënësve - Mësuesit kanë ndihmuar në zhvillimin e të menduarit kritik dhe reflektimit
	Realizimi i inkluzionit arsimor	- Është mbajtur dokumentacioni për PIA për nxënësve me nevojë të veçanta - Janë organizuar takime me ekipin për inkluzion Është ofruar mbështetje e vazhdueshme për integrimin e këtyre nxënësve në klasë
	Aktivitetet për integrim ndëretnik në arsim	- Janë realizuar projekte të përbashkëta me shkollat e tjera - Janë zhvilluar aktivitete jashtëmësimore me përfshirje ndëretnike - Janë hartuar raporte nga EISH për ecimin e integritit

nga ekipet e integritit shkollor (EISH), raportet nga aktivitetet e realizuara të integritit ndëretnik, duke përfshirë klasat e përbashkëta; materialet nga procedura për përcaktimin e lëndëve dhe aktiviteteve zgjedhore/ të lira; planifikimet për lëndë zgjedhore		
---	--	--

Indikatori 1.3 Përvojat e nxënësve nga nxënia

Burimet e të dhënave	Temat sipas treguesve	Informacionet që janë mbledhur
----------------------	-----------------------	--------------------------------

Anketë me nxënësit, prindërit/kujdestarët dhe mësimdhënësit; biseda në fokus grupe me nxënësit, prindërit/kujdestarët dhe mësimdhënësit; bisedë me shërbimin profesional; qasje në dosjet e nxënësve; qasje në evidencën e bashkëpunësve profesionalë.	Mjedisi dhe atmosfera për nxënie	Nga të dhënat e mbledhura përmes anketës me 36 nxënës dhe bisedave në fokus grupe me nxënësit, prindërit dhe mësimdhënësit, si dhe nga komunikimi me shërbimin profesional, evidencat dhe dosjet e nxënësve, rezulton se: - Nxënësit ndihen të sigurt dhe të pranuar në mjedisin shkollor. Ata shprehen se kanë mundësi të mësojnë në mënyra të ndryshme, përmes projekteve, lojërave, kërkimit dhe materialeve të ndryshme mësimore. - Mësuesit vlerësohen pozitivisht për përkushtimin dhe mbështetjen që ofrojnë. Nxënësit ndihen të inkurajuar për të marrë pjesë në projekte, konkurse dhe aktivitete jashtëshkollore sipas interesave të tyre. - Atmosfera në klasë është bashkëpunuese. Nxënësit shprehen se kanë liri të pyesin, të shprehin mendimin dhe të kërkojnë ndihmë kur nuk e kuptojnë diçka. - Notimi vlerësohet si i drejtë dhe nxënësit marrin informacione për arritjet dhe mënyrat e përmirësimit të tyre. - Pjesa më e madhe e nxënësve shprehen se dëshirojnë të vijnë në shkollë dhe ndihen të motivuar për të mësuar. - Prindërit janë të informuar rregullisht për progresin e fëmijëve të tyre dhe bashkëpunojnë me shkollën në raste të nevojshme.
--	----------------------------------	---

		Evidencat tregojnë se mësuesit dhe bashkëpunëtorët profesionalë ofrojnë mbështetje shtesë për nxënësit me vështirësi dhe mbështesin zhvillimin e të gjithëve në mënyrë gjithëpërfshirëse.
	Identifikimi dhe përmbushja e nevojave të ndryshme arsimore të nxënësve	- Nxënësit deklarojnë se mësuesit i kuptojnë nevojat dhe vështirësitë e tyre dhe janë të gatshëm t'i ndihmojnë. Kur hasin vështirësi në përvetësimin e materialit, mësuesit organizojnë orë shtesë ose përdorin mënyra të ndryshme për ta shpjeguar atë. - Për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore është realizuar vlerësim dhe janë hartuar plane individuale zhvillimi në bashkëpunim me shërbimin profesional të shkollës. - Bashkëpunëtorët profesionalë (psikologu/pedagogu) janë të përfshirë në identifikimin dhe mbështetjen e nxënësve që kanë nevojë për ndihmë shtesë, si në aspektin akademik ashtu edhe emocional/social. - Prindërit janë të përfshirë në procesin e identifikimit të nevojave dhe planifikimit të mbështetjes, dhe raportohen rregullisht për progresin e fëmijëve të tyre. - Nxënësve u jepen mundësi shtesë për të mësuar më shumë mbi tema që i interesojnë, duke përfshirë projekte, punë individuale, ose zgjerime jashtë kurrikulës së rregullt. - Nxënësit me rezultate të larta motivohen për të marrë pjesë në konkurse dhe sfida intelektuale, ndërsa atyre me vështirësi u sigurohet ndihmë e personalizuar.
Indikatori 1.4 Notimi si pjesë e mësimi		
Burimet e të dhënave	Temat sipas treguesve	Informacionet që janë mbledhur
Programi i punës së shkollës; orari i mësimi shtesë dhe plotësues; listat e nxënësve të përfshirë në	Politika shkollore e notimit	Shkolla zbaton politikën e notimit të përcaktuar nga MASH dhe ka të integruara rregulla të brendshme për mënyrën e vlerësimit të nxënësve. Notimi është i vazhdueshëm dhe përfshin të gjitha format e vlerësimit: përmbledhës, formativ dhe vetëvlerësim.

mësimin shtesë dhe plotësues; rregullat për notimin dhe përparimin e nxënësve; rregullat e brendshme për notim; qasja në evidencën dhe dokumentacionin pedagogjik; instrumentet e përdorura të notimit; shembuj të punimeve të vlerësuara të nxënësve; procesverbalet e aktiveve profesionale, këshilli mësimdhënës; anketat/intervistat me nxënësit dhe mësimdhënësit, prindërit/kujdestarët; instrumentet për mënyrat e individualizuara të verifikimit	Metodat, format dhe instrumentet e notimit	Mësimdhënësit përdorin një gamë të gjerë metodash dhe instrumentesh për notim, përfshirë teste, ese, punë praktike, pyetësorë, portofoli dhe vlerësime gojore. Përdoren gjithashtu rubrika të vlerësimit dhe skema të pikëzimit për objektivitë.
	Koeficienti i vazhdimësisë së suksesit të nxënësve	Nga analiza e rezultateve vjetore të nxënësve, vërehet një vazhdimësi pozitive në përmirësimin e suksesit. Shkolla përdor statistika dhe krahasime vjetore për të identifikuar tendencat e përparimit të nxënësve.
	Përdorimi i informacioneve nga notimi në mësim	Nga analiza e rezultateve vjetore të nxënësve, vërehet një vazhdimësi pozitive në përmirësimin e suksesit. Shkolla përdor statistika dhe krahasime vjetore për të identifikuar tendencat e përparimit të nxënësve.

Indikatori 1.5 Aktivitete dhe gara jashtëshkollore

Burimet e të dhënave	Temat sipas treguesve	Informacionet që janë mbledhur
Programi vjetor i punës; programet për aktivitete jashtëshkollore; raporti i ekskursioneve të realizuara; evidenca dhe dokumentacioni pedagogjik; diplomat, mirënjohjet, përgëzimet nga pjesëmarrja në manifestime dhe gara; intervistat/anketat me mësimdhënësit, prindërit/kujdestarët,	Vëllimi dhe shumëllojshmëria e aktiviteteve të planifikuara dhe të realizuara jashtëshkollore	Nga shqyrtimi i programit vjetor të punës dhe planeve për aktivitetet jashtëshkollore, është evidentuar një gamë e gjerë aktiviteteve të planifikuara dhe të realizuara gjatë vitit shkollor. Në bazë të dokumentacionit pedagogjik, procesverbaleve të aktiveve profesionale dhe listave të nxënësve pjesëmarrës, janë zhvilluar aktivitete në fusha të ndryshme si: • aktivitete kulturore (shfaqje, vizita në institucione kulturore), • sportive (gara, aktivitete të përbashkëta me shkolla të tjera), • ekologjike (aksione për pastrimin e ambientit, punëtori për mbrojtjen e natyrës), • humanitare (ndihmë për familje në nevojë, aktivitete me moton "Nxënësit ndihmojnë nxënësit"),

nxënësit dhe bashkëpunëtorët profesionalë për aktivitete jashtëshkollore; procesverbalet e aktiveve profesionale dhe bashkësisë së nxënësve; lista e nxënësve të përfshirë në aktivitete jashtëshkollore; qasje në faqen e internetit, në gazetat, programin e radios, rrjetet sociale, etj.; plani i veprimit për të drejtat e fëmijës.		• edukative (vizita mësimore, ekskursione, punëtori tematike me përfshirjen e prindërve dhe komunitetit), • si dhe përfshirja në projekte me karakter ndërkulturor dhe bashkëpunues me institucione të jashtme. Gjithashtu janë analizuar intervistat me mësimdhënësit dhe prindërit, ku është vlerësuar pozitivisht larmia e aktiviteteve dhe ndikimi i tyre në përfshirjen aktive të nxënësve. Evidenca e diplomave dhe mirënjohjeve nga pjesëmarrja në manifestime dhe gara është një tregues shtesë i përfshirjes së gjerë të shkollës në jetën jashtëkurrikulare.
	Përfshirja e nxënësve të gjinive dhe gjuhëve të ndryshme mësimore me aktivitete jashtëshkollore	Në bazë të listave të pjesëmarrjes në aktivitetet jashtëshkollore dhe dokumentacionit të mbajtur nga shkolla, rezulton se nxënësit janë përfshirë në mënyrë të barabartë, pa dallim gjinor apo gjuhësor. Aktivitetet e zhvilluara kanë pasur karakter gjithëpërfshirës, duke mundësuar pjesëmarrjen e nxënësve nga të gjitha paralelet mësimore në gjuhë të ndryshme (shqipe dhe maqedonase) si dhe të të dy gjinive. Në shumë aktivitete janë formuar grupe të përziera me qëllim nxitjen e bashkëpunimit, tolerancës dhe ndërlidhjes ndërmjet nxënësve. Për më tepër, nga intervistat dhe anketat me mësimdhënësit dhe prindërit, është vlerësuar angazhimi i shkollës për të krijuar mundësi të barabarta për të gjithë nxënësit. Procesverbalet e aktiveve profesionale tregojnë gjithashtu se gjatë planifikimit është pasur kujdes për përfaqësim të balancuar gjinor dhe gjuhësor.
	Përfshirja e nxënësve në përzgjedhjen dhe planifikimin e punës së aktivitete jashtëshkollore	Bazuar në procesverbalet e mbledhjeve të bashkësisë së nxënësve dhe të aktiveve profesionale, rezulton se nxënësit janë përfshirë në fazat fillestare të planifikimit të aktiviteteve jashtëshkollore. Nxënësve u është dhënë mundësia të propozojnë ide dhe të shprehin interesat e tyre për aktivitetet që dëshirojnë të zhvillohen gjatë vitit shkollor.

	Përmes anketave dhe intervistave me nxënësit dhe mësime dhënësit, u konstatua se sugjerimet e nxënësve janë marrë parasysh në përgatitjen e programeve jashtëshkollore, si në zgjedhjen e temave për punëtori, aktivitete kulturore e sportive, ashtu edhe në organizimin e ekskursioneve. Pjesëmarrja aktive e nxënësve në këtë proces ka kontribuar në rritjen e motivimit dhe përfshirjes së tyre në aktivitete, si dhe ka nxitur ndjenjën e përgjegjësisë dhe bashkëpunimit ndërmjet nxënësve dhe stafit mësues.
Garat	Nga të dhënat në evidencat pedagogjike, raportet për aktivitete jashtëshkollore dhe mirënjohjet e fituara, rezulton se shkolla ka marrë pjesë në një sërë garash komunale, rajonale dhe shtetërore në fusha të ndryshme: arsimore, artistike dhe sportive. Nxënësit janë përfshirë në mënyrë aktive në përgatitjen për gara dhe janë udhëhequr nga mësime dhënësit përgjegjës për fushat përkatëse. Janë evidentuar raste të fitimit të çmimeve dhe diplomave për arritje të larta, të cilat janë prezantuar në ambientet e shkollës dhe rrjetet sociale të institucionit. Përmes intervistave dhe anketave, nxënësit kanë shprehur interes dhe motivim për të marrë pjesë në gara, ndërsa prindërit dhe mësime dhënësit i vlerësojnë këto si mundësi të mira për zhvillimin e aftësive dhe vetëbesimit tek nxënësit.

Gjatë vitit shkollor janë realizuar një sërë aktiviteteve jashtëshkollore me karakter edukativ, kulturor dhe ndërgjegjësues. Aktivitetet janë organizuar në përputhje me datat dhe temat përkatëse, si në vijim:

- **20 Nëntor** – Dita Botërore e të Drejtave të Fëmijëve
- **22 Nëntor** – Dita e Alfabetit
- **28 Nëntor** – Dita e Flamurit
- **3 Dhjetor** – Dita Botërore e Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara
- **31 Dhjetor** – Festat e fundvitit
- **7 dhe 8 Mars** – Dita e Mësuesit dhe Dita e Nënës
- **21 Mars** – Dita e Ekologjisë
- **22 Mars** – Dita Botërore e Ujit
- **2 Prill** – Dita Botërore e Librit për Fëmijë dhe Dita e Autizmit
- **22 Prill** – Dita e Tokës
- **1 Qershor** – Dita e Fëmijëve

Këto aktivitete përfshijnë nxënësit në mënyrë të drejtpërdrejtë përmes recitimeve, shfaqjeve, ekspozitave, punimeve kreative, aktiviteteve ekologjike dhe pjesëmarrjes në diskutime tematike. Aktivitetet janë dokumentuar me fotografi, video dhe janë reflektuar në faqet zyrtare të shkollës dhe rrjetet sociale.









Rezultatet nga anketimi i zhvilluar me 36 nxënës tregojnë se shumica ndihen të përfshirë, të motivuar dhe të mbështetur në procesin mësimor. Nxënësit vlerësojnë mjedisin e sigurt në shkollë, mënyrat e ndryshme të të nxënës dhe përfshirjen në aktivitete sipas interesave të tyre. Vlerësimi konsiderohet i drejtë dhe nxënësit ndihen të lirë të kërkojnë ndihmë dhe të shprehin mendimet e tyre.

Fusha e vlerësuar	Përqindja e nxënësve që u përgjigjën pozitivisht
Mësojnë në mënyra të ndryshme dhe përfshihen sipas interesave	85%
Ndihen të përfshirë në mësim dhe të motivuar për projekte/konkurse	80%
Ndihen të sigurt dhe të pranuar në shkollë	90%
Vlerësimi është i drejtë dhe marrin informacione për përmirësimin	83%
Marrin pjesë në aktivitete jashtëshkollore me dëshirë	87%
Mund të shprehin lirshëm mendimet dhe të kërkojnë ndihmë	78%

Rezultatet e Anketës për Prindërit (36 prindër të anketuar)

Nga përgjigjet e prindërve për pyetjet e dhëna, rezulton se shumica janë të kënaqur me mjedisin dhe mënyrën e punës së shkollës. Përqindjet janë llogaritur duke marrë parasysh numrin e prindërve që kanë zgjedhur përgjigjet pozitive ("4 - plotësisht dakord" dhe "3 - dakord").

Fusha e vlerësuar	Përqindja e prindërve që u përgjigjën pozitivisht
Fëmija ndjek lëndët dhe aktivitetet sipas interesave	89%
Mësuesit përshtatin detyrat sipas nevojave individuale	85%
Fëmija mund të shprehet lirisht në orë mësimi	92%
Shkolla është një mjedis i sigurt dhe motivues	90%
Prindërit informohen rregullisht për arritjet e fëmijës	87%
Mësuesit lavdërojnë dhe mbështesin fëmijët	88%
Fëmija përfshihet në aktivitete jashtëshkollore	84%
Shkolla trajton drejtësinë dhe disiplinën në mënyrë të barabartë	86%

Shumica e prindërve janë të kënaqur me cilësinë e arsimit, atmosferën në shkollë dhe mbështetjen që fëmijët e tyre marrin. Kjo tregon se shkolla po përmbush mirë nevojat e nxënësve dhe po krijon një ambient të favorshëm për mësim dhe zhvillim. Megjithatë, rekomandohet që të vazhdohet përmirësimi në komunikimin me prindërit dhe ofrimin e aktiviteteve shtesë për fëmijët.

Fusha e vlerësuar	Përqindja e mësimeve që u përgjigjen
Marr trajnim në kohë për metodat dhe teknikat moderne të planifikimit	85%
Drejtori dhe shërbimi profesional monitorojnë planifikimin tim dy herë në semestër	90%
Përdor burime të ndryshme mësimore dhe qasje që nxisin kërkimin dhe zgjidhjen e problemeve	90%
Inkurajoj nxënësit të bëjnë pyetje dhe punojnë në mënyra bashkëpunuese	90%
Trajoj nxënësit me respekt dhe i kuptoj nevojat e tyre	95%
Lavdëroj rregullisht nxënësit për rezultatet dhe përpjekjet	90%
Përdor mënyra të ndryshme të vlerësimit dhe përfshij nxënësit në vetëvlerësim	70%
Bashkëpunoj me prindërit dhe u jap udhëzime të qarta për ndihmën e fëmijëve	80%
Atmosfera në shkollë dhe gjatë orëve të mësimi është pozitive dhe inkurajuese	90%
Bashkëpunoj mirë me kolegët dhe marr pjesë në trajnime për përmirësim profesional	85%
Jam i njohur me mënyrën se si shpenzohet buxheti i shkollës	55%

Përfundim mbi Vetëvlerësimin e Mësimeve

Rezultatet e vetëvlerësimit tregojnë një nivel të lartë angazhimi dhe profesionalizmi nga ana e mësimeve në shumicën e fushave të rëndësishme të procesit mësimor. Mësimi deklarohet me shumicë (85–95%) se:

- marrin pjesë në trajnime për metodat moderne të mësimdhënies,
- përdorin qasje të ndryshme për të nxitur mendimin kritik dhe punën bashkëpunuese të nxënësve,
- lavdërojnë rregullisht përpjekjet dhe arritjet e nxënësve,

- krijojnë një atmosferë pozitive dhe inkurajuese gjatë procesit mësimor,
- dhe bashkëpunojnë mirë me kolegët si dhe me drejtuesit e shkollës.

Një fushë që shfaq potencial për përmirësim është **përdorimi i mënyrave të ndryshme të vlerësimit dhe përfshirja e nxënësve në vetëvlerësim**, ku vetëm 70% e mësimitdhënësve raportojnë përfshirje të rregullt. Po ashtu, **njohuritë mbi mënyrën e shpenzimit të buxhetit të shkollës** janë të kufizuara, me vetëm 55% të mësimitdhënësve që janë të informuar.

Këto të dhëna sugjerojnë nevojën për:

- forca të reja në trajnimin mbi format alternative të vlerësimit,
- përmirësimin e transparencës dhe përfshirjes së stafit në çështjet financiare të shkollës.

Në përgjithësi, vetëvlerësimi pasqyron një kulturë profesionale pozitive dhe përkushtim të mësimitdhënësve për përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë së mësimitdhënies.

Fusha 1: Planifikimi, mësimi dhe nxënia

Përshkrimi/përmbledhja e fushës

Gjatë këtij viti shkollor, mësimdhënësit kanë planifikuar dhe realizuar mësimin në përputhje me kurrikulën kombëtare dhe udhëzimet pedagogjike të Ministrisë së Arsimit. Planifikimi është bërë në mënyrë të strukturuar, duke marrë parasysh nevojat individuale të nxënësve, kompetencat që duhen zhvilluar dhe përdorimin e metodave bashkëkohore të mësimdhënies. Në procesin mësimor janë përdorur teknika të ndryshme interaktive si punë në grupe, zgjidhje problemesh, diskutime dhe projekte, të cilat kanë ndikuar pozitivisht në përfshirjen aktive të nxënësve dhe arritjen e kompetencave kyçe. Gjithashtu, janë përdorur mjete dhe burime të ndryshme mësimore për të mbështetur të nxënësit aktiv dhe gjithëpërfshirës. Vëmendje e veçantë i është kushtuar diferencimit dhe përshtatjes së detyrave sipas aftësive dhe interesave të nxënësve, duke siguruar qasje të barabartë për të gjithë. Vlerësimi i nxënësve është kryer përmes formave të ndryshme si vetëvlerësimi, vlerësimi nga bashkëmoshatarët dhe vlerësimi nga mësimdhënësi, duke i ndihmuar nxënësit të reflektojnë mbi të nxënin e tyre dhe të përmirësojnë arritjet.

Anët e forta

Mësimi në shkollë realizohet rregullisht dhe në vëllimin e përcaktuar. Shkolla kujdeset rregullisht për shëndetin e nxënësve, në shkollë ka Procedurë për kujdesin ndaj nxënësve me probleme shëndetësore, sëmundje kronike dhe lëndime të rënda, e cila është përgjithësisht e pranuar dhe e zbatuar nga nxënësit, mësimdhënësit dhe prindërit dhe është pjesë e kulturës së shkollës. Shkolla zbaton aktivitete specifike jashtëshkollore për të cilat dallohet në mjedisin. Shkolla në nivelin e aktiveve profesionale ka kritere të ndërtuara për notim në përputhje me standardet kombëtare. Prindërit/kujdestarët marrin rregullisht informacione për arritjet e nxënësve pas çdo periudhe të kualifikimit, Shkolla ka protokoll të qartë të veprimit në raste të dhunës.

Anët e dobëta

Nxënësit arrijnë rezultatet më të dobëta në lëndën e matematikës, veçanërisht në klasën e gjashtë, Një numër i vogël i nxënësve dhe prindërve/kujdestarëve janë deklaruar se janë të njoftuar me kriteret e notimit.

Prioritetet

Përmirësimi i arritjeve në matematikë tek nxënësit e klasave të gjashta dhe të shtata, Siguroni një përzgjedhje më të madhe të burimeve dhe materialeve për punën në orët e mësimi, Përfshirja e nxënësve në planifikimin e aktiviteteve dhe vendimmarrja në shkollë. Sigurimi i cilësisë më të mirë dhe punës më të suksesshme të shkollës, Përfshirja e prindërve/kujdestarëve në aktivitete, edukime dhe punëtori të përbashkëta, Krijimi i procedurave për motivimin dhe përzgjedhjen e nxënësve që do të marrin pjesë në gara.

ANËTARËT E EKIPIT- Planifikimi, mësimi dhe nxënia

- 1.Ardita Ziberi
- 2.Jetmire Amiti
- 3.Besa Arifi
- 4.Sevime Sadiku
- 5.Nexhmije Xhelili
- 6.Blerta Bajraktari
- 7.Fadil Abdulhalimi

FUSHA 2. TË ARRITURAT E NXËNËSVE

Ndarjet në kuadër të temës:

2.1 Të arriturat e nxënësve

- *Monitorimi i arritjeve të nxënësve të gjinive dhe gjuhëve të ndryshme mësimore sipas lëndëve mësimore dhe sipas periudhave të kualifikimit*
- *Rezultate e nxënësve nëpër gara*
- *Identifikimi dhe mbështetja e nxënësve me vështirësi në nxënien, nxënësve të talentuar dhe nxënësve me aftësi të kufizuara*
- *Njoftimi i prindërve/kujdestarëve për arritjet e nxënësve*

2.2 Masat për përmirësimin e arritjeve

- *Rregullsia në mësim*
- *Këshillimi i prindërve/kujdestarëve dhe nxënësve*
- *Përmirësimi i arritjeve të nxënësve përmes mësimi të rregullt dhe plotësues*



Mbledhja e të dhënave

Dokumentet e kontrolluara.

Cilat informacione janë mbledhur?

2.1 Të arriturat e nxënësve<i>Monitorimi i arritjeve të nxënësve të gjinive dhe gjuhëve të ndryshme mësimore sipas lëndëve mësimore dhe sipas periudhave të kualifikimit</i> Temat :  Raporti i suksesit për vitin shkollor 2023/2024 2024/2025  Suksesi i nxënësve në fund të vitit shkollorë 2023/2024 2024/2025  Libri kryesor  Ditari	❖ Shkolla jonë punon për të rritur suksesin e nxënësve përmes testeve të ndryshme të organizuara nga mësimdhënësit, shërbimi profesional dhe strukturat e tjera të institucionit. Përparimi i nxënësve mbështetet gjithashtu edhe nga organizimi i orëve shtesë, ndihmës, aktiviteteve jashtëmësimore, garave ndërmjet nxënësve si dhe përmes kryerjes së detyrave të shtëpisë. ❖ Analizojnë arritjet sipas lëndëve mësimore, si matematika, gjuha amtare, shkenca natyrore, gjuhët e huaja, etj.; ❖ Suksesi i nxënësve nga klasa e katërt deri në klasën e nëntë për vitin shkollor 2023/2024, 2024/2025 sipas klasave. ❖ Në vitin shkollor 2023/2024 mbaruan gjithsej 267 nxënës prej të cilëve 93 janë nxënës shqiptarë nga klasa e parë deri në të tretën dhe 3 nxënës maqedon që janë notuar me notim përshtatës, ndërsa prej klases së katërt deri në të nëntën 169 nxënës shqiptarë dhe 2 nxënës maqedon që janë vlerësuar me nota. ❖ Në vitin shkollor 2024-2025 mbaruan gjithsej 291 nxënës prej të cilëve 125 janë nxënës shqiptarë dhe 4 nxënës janë maqedon nga klasa e parë deri në të tretën që janë me notim përshtatës, ndërsa prej klases së katërt deri në të nëntën 162 nxënës shqiptarë dhe 2 nxënës maqedon që janë vlerësuar me nota. ❖ Në shkollën tonë, krahasimi i rezultateve të nxënësve realizohet në bazë të të dhënave statistikore të përgatitura nga arsimtarët kujdestarë dhe shërbimi profesional. Ky proces zhvillohet në tre periudha: në fund të tremujorit të parë, në fund të gjysmëvjetorit dhe në fund të vitit shkollor. Këto analiza ndihmojnë në vlerësimin e përparimit të nxënësve dhe në identifikimin e nevojave për mbështetje të mëtejshme. ❖ Nxënësit që hasin vështirësi në të nxënë monitorohen nga kujdestarët e klasës në bashkëpunim me mësimdhënësit e tjerë, shërbimin profesional të shkollës dhe edukatoren speciale.Ky bashkëpunim siguron një mbështetje të koordinuar dhe gjithëpërfshirëse për nxënësit, duke ndihmuar në identifikimin e nevojave të tyre specifike dhe në zhvillimin e strategjive të përshtatura për përmirësimin e performancës së tyre akademike dhe sociale...Për këto nxënës është i nevojshëm: Mësim i diferencuar – përshtatje e metodave të mësimdhënies sipas nevojave të nxënësit. Ndihmë shtesë – përmes orëve shtesë, tutorëve ose mentorëve.
--	--

 Parlamenti i nxënësve	Përdorimi i teknologjisë – aplikacione, video edukative, dhe mjete interaktive për të bërë mësimin më të kuptueshëm. Ndërtimi i vetëbesimit – përforsim pozitiv, lavdata dhe përfshirje në aktivitete që i motivojnë. Mbështetje psikologjike dhe emocionale – përmes këshillimeve dhe aktiviteteve për zhvillim personal Përfshirja e prindërve – komunikim i rregullt dhe ndihmë në shtëpi. ❖ Mësimdhënësit e mbajnë dhe e përditësojnë në mënyrë të rregullt ditarin elektronik. ❖ Të gjithë nxënësit janë regjistruar në regjistrin shkollor dhe çdo ndryshim në statusin e tyre, siç janë transferimet brenda ose jashtë shkollës, dokumentohet aty. Kjo mundëson që të dihet arsyeja pse një nxënës nuk ndodhet më në shkollën tonë. ❖ Ky riformulim ruan informacionin e origjinalit, duke përdorur një strukturë më të thjeshtë dhe fjalë të tjera. ❖ Nxënësit e shkollës sonë janë të angazhuar në mënyrë të përhershme në organizimin e takimeve të Parlamentit të Nxënësve. Ata i marrin këto angazhime me përgjegjësi të madhe dhe në çdo takim shprehin mendimet e tyre për: zhvillimin e procesit edukativo-arsimor, arritjet në mësim, sfidat, motivimin, interesat, qëllimet dhe çështjet e ndryshme që hasin në shkollë, të analizuar nga këndvështrimi i nxënësve. Takimet e realizuara regjistrohen në procesverbal. Çdo takim shqyrtohet dhe merret parasysh nga drejtoria. Kërkesat, vërejtjet dhe sugjerimet konstruktive janë gjithmonë të vlerësuara dhe kanë sjellë ndryshime të dukshme.
--	--

Burimet	Programet dhe raportet shkollore, raportet nga shërbimet profesionale, analizat e suksesit, procesverbalet nga organet profesionale të shkollës, etj.									
Raporti suksesit nga arsimtarët për vitin shkollor 2023/2024										
Raport i suksesit nga arsimtarët për vitin shkollor 2024/2025										
Mesatarja e v.sh 2023/2024 është										
Mesatarja e vsh 2024/2025 është										
	Klasa	V.Sh. 2023-2024 Nota mesatare e klasave		Klasa	V.Sh. 2024-2025 Nota mesatare e klasave					
	I	Notim përshkrues		I	Notim përshkrues					
	II	Notim përshkrues		II	Notim përshkrues					
	III	Notim përshkrues		III	Notim përshkrues					
	IV	4.22		IV	4.3					
	V	4.01		V	4.1					
	VI	4.29		VI	4.2					
	VII	4.5		VII	4.22					
	VIII	4.30		VIII	4.4					
	IX	4.6		IX	4.5					

		Paralele e kombinuar I-V	4.7			5.0
			4.41	Dallimi ndermjet 2023/24-2024/25 është në rënie për 0.01		4.4
Metoda tjera për mbledhjen e të dhënave	Informacionet u mbledhën nga:	d Informacionet e mbledhura				
 Bisedë me nxënës, mësues dhe prindër	Ekipi për mbledhjen e të dhënave	 Informacionet të cilat janë marrë rreth mënyrës së vlersimit dhe notimit të nxënësve:  Në shkollën tonë, përdoren disa metoda dhe teknika moderne për të vlerësuar arritjet e nxënësve. Këto përfshijnë përpilimin e testeve që përdoren për vlerësimin e arritjeve të nxënësve, mësimin shtues dhe plotësues, si dhe aktivitete të lira si gara shkollore. Këto metoda ndihmojnë në zhvillimin e aftësive të nxënësve dhe në përmirësimin e procesit mësimor.				

 Anketë me nxënës	Ekipi për mbledhjen e të dhënave	 Në shkollën tonë, çdo vit realizohet një anketë me nxënësit për të vlerësuar procesin e notimit. Rezultatet e anketës tregojnë se nuk ka vërejtje në lidhje me drejtësinë e notimit. Bazuar në këto të dhëna, arsimtarët renditen sipas objektivitetit dhe paanshmërisë në vlerësimin e nxënësve.
 Anketë me prindër	Ekipi për mbledhjen e të dhënave	 Notimi realizohet drejtë në bazë të të anketuarve.  Procesi i notimit realizohet në mënyrë të drejtë dhe objektive, sipas të dhënave të mbledhura nga anketat e realizuara me nxënësit. Për sa i përket përshtypjeve të prindërve mbi suksesin e fëmijëve të tyre, 85% e tyre shprehin kënaqësi, ndërsa 15% shprehin pakënaqësi.
 Ankete me arsimtarët	Ekipi për mbledhjen e të dhënave	Sipas rezultateve të anketës me mësuesit, 65% e të anketuarve mendojnë se është e nevojshme të përdoren metoda të reja dhe interaktive në mësim. Këto përfshijnë: • Mësim interaktiv: Metoda që inkurajon pjesëmarrjen aktive të nxënësve përmes diskutimeve dhe aktiviteteve praktike. • Mësim në grupe: Nxënësit punojnë së bashku për të zgjidhur probleme ose për të mësuar një koncept të ri. Ky qasje promovon bashkëpunimin dhe zhvillon aftësitë e komunikimit dhe të punës në grup. • Mësim në kabinete: Përdorimi i hapësirave të specializuara për aktivitete të caktuara, si laboratorë ose klasa të pajisura me teknologji, për të ofruar një mësim më të fokusuar dhe të thelluar.
	Pedagogu	➤ Vlerësimi i nxënësve në shkollën tonë fillore bëhet në mënyrë të vazhdueshme dhe të gjithanshme. Ai përfshin vlerësimin e dijes, përpjekjes, pjesëmarrjes dhe përparimit të çdo nxënësi. Përdoren metoda të ndryshme si detyra me shkrim, teste, vëzhgim gjatë mësimi si dhe komente për përmirësim. Qëllimi i vlerësimit është të ndihmojë fëmijët të mësojnë më mirë dhe të zhvillohen sipas ritmit të tyre.

Dokumentet e kontrolluara.	Cilat informacione janë mbledhur?						
Viti shkollor 2024/25	Pasqyra tabelare e numrit të mungesave për dy vitet e fundit shkollor 2023-2024 dhe 2024-2025						
Me arsye 7094							
Pa arsye 169							
Gjithsej 7263							
2.1Mbajtja / shpërndarja e nxënësve	KLASA	I	II	III	IV	V	IX
	MASHKULL					1	1
	FEMËR		1			1	1
	P.e kombinuar						
Temat:	Pasqyra e nxënësve që janë çregjistruar viti 2024-2025						
• Përfshierja e nxënësve	KLASA	I	II	III	IV	V	VI
	MASHKULL				1	1	
	FEMËR						
	P. e kombinuar						
• Rregullshmëria në mësim							
• Shpërndarja e nxënësve							
Burimet	Krahasimi i rezultateve të nxënësve realizohet në bazë të të dhënave statistikore të përgatitura nga arsimtarët kujdestarë dhe shërbimi profesional.Ky proces zhvillohet në tre periudha: në fund të tremujorit të parë, në fund të gjysmëvjetorit dhe në fund të vitit shkollor.Këto analiza ndihmojnë në vlerësimin e përparimit të nxënësve dhe në identifikimin e nevojave për mbështetje të mëtejshme.						

Mbledhja e të dhënave

Dokumentet e kontrolluara.	Cilat informacione janë mbledhur?
2.2 Përsëritja e nxënësve Temat: • Nxënësit që nuk e mbarojnë klasën Burimet	Të gjithë nxënësit e shkollës kanë përfunduar vitin shkollor për periudhat 2023/2024 dhe 2024/2025. Kontrollimi dhe vlerësimi i arritjeve të tyre janë pjesë kyçe e procesit mësimor, sepse nëpërmjet tyre merren informacione për përparimin e nxënësve. Këto të dhëna ndihmojnë në identifikimin e problemeve dhe vështirësive, si dhe në planifikimin e masave për përmirësim. Sipas taksonomisë së Blumit, çdo nxënës zotëron njohuri specifike që lidhen me përkujdesjen dhe riprodhimin e informatave të veçanta dhe të izoluara. Nxënësit njohin terminologjinë dhe fakte të caktuara si data, ngjarje, vende etj. Kjo njohuri nënkupton aftësinë për të kujtuar dhe përshkruar fakte dhe nocione të përgjithshme. Për këtë arsye, sipas taksonomisë së Blumit, përsëritja e nxënësve nuk është e nevojshme, pasi secili nxënës ka aftësinë të kujtojë informacion të veçantë. Analizat e suksesit të nxënësve gjatë dy viteve të fundit, së bashku me dokumentacionin pedagogjik dhe bisedat me shërbimet profesionale, konfirmojnë këtë përfundim.

Rezultatet: Anët e forta dhe të dobëta të shkollës

Anët e forta

1. Stafi i kualifikuar dhe i përkushtuar

- Mësues me përgatitje profesionale dhe përvojë të mirë
- Pjesëmarrje aktive në trajnime dhe zhvillim profesional
- Komunikim i mirë mes mësimeve dhe nxënësve

2. Cilësia e mësimit

- Planifikim i mirë mësuesor
- Përdorimi i metodave aktive dhe bashkëkohore të mësimit
- Përshtatje e mësimit sipas nevojave të nxënësve
- Përfshirje e teknologjisë në mësim

3. Mjedis shkollor i sigurt dhe i mirëorganizuar

- Shkollë e pastër dhe e mirëmbajtur
- Respekt i ndërsjellë ndërmjet stafit, nxënësve dhe prindërve
- Rregulla të qarta dhe të zbatueshme për disiplinën
- Mbështetje për mirëqenien emocionale dhe sociale të nxënësve

4. Arritje të mira të nxënësve

- Rezultate të qëndrueshme në testime dhe olimpiada
- Zhvillim i aftësive kritike, sociale dhe krijuese

- Pjesëmarrje në gara, aktivitete kulturore, sportive dhe artistike

5. Bashkëpunimi me prindërit dhe komunitetin

- Takime të rregullta prind-mësues
- Përfshirje e prindërve në vendimmarrje dhe aktivitete
- Projekte të përbashkëta me institucione vendore

6. Menaxhim i mirë institucional

- Drejtues shkollor me vizion dhe aftësi drejtuese
- Vendimmarrje transparente dhe gjithëpërfshirëse
- Planifikim strateg

Anët e dobëta

- ❖ *Përdorim i metodave tradicionale pa përfshirje të risive pedagogjike*
- ❖ *Përdorim i kufizuar i metodave aktive të nxënësve*
- ❖ *Mungesë pajisjesh mësimore moderne*

Aktivitetet e nxënësve

Më datë 07.03.2024 në Sh.F.K “Kiril Pejcinoviq”-Tearcë u organizua kuiz diturie me nxënësit e klasave të IX-ta dhe klasave të VIII-ta të shkollës sonë dhe nxënësit e shkollave tjera komunale. Më datë 18.02.2024 nxënësit e klasave të IX-ta morën pjesë në gara rajonale në lëndën e fizikës dhe matematikës në kolegjin “Yahya Kemal”. Më datë 25.04.2024 nxënësit e klasave të IX-ta dhe klasave të VII-ta morën pjesë në gara rajonale të koreve dhe orkestrave. Më datë 02.02.2024 nxënësi Dhurim Zaiti në garat komunale në matematikë mori vendin e parë. Më datë 18.03.2023 nxënësit e klasave VIII-ta dhe klasave të IX-ta morën pjesë në gara komunale të gjuhës angleze të organizuara nga ELTAM. Në këto gara nxënësja Gerta Amiti klasa e IX-të u shpërblye me vendin e dytë, kurse nxënësi Dhurim Zaiti klasa e VIII-të gjithashtu u shpërblye me vendin e dytë. Më datë 08.04.2023 u mbajtën garat regjionale në gjuhë angleze, ku nxënësja Gerta Amiti klasa e IX-të mori vendin e dytë, ndërsa nxënësi Dhurim Zaiti klasa e VIII-të mori vendin e tretë. Më datë 15.02.2025 nxënësit e shkollës sonë morën pjesë në garat e gjuhës angleze, në kuadër të shtetit, të mbajtura në Veles, KGL-National Contest in English ku të gjithë nxënësit pjesëmarrës në këtë garë e kaluan pragun e niveleve të caktuara (PRE-A1,A2,B1). Në këtë garë nxënësi Dion Asani u kualifikua për raundin e dytë. Më 23 prill 2025, Ditës Botërore të Librit, nxënësit e shkollës sonë në kuadër të bibliotekës së qytetit, morën pjesë në gara me poezi, ku nxënësja Anesa Fejzuli klasa e IX-të u shpërblye me mirënjohje.

Analiza e rezultateve

Shkolla ka një kulturë të zhvilluar të ndjekjes dhe përmirësimit të arritjeve të nxënësve. Qasja është gjithëpërfshirëse, progresive dhe e fokusuar në nxënësin. Megjithatë, për të ruajtur dhe avancuar më tej suksesin, kërkohet vazhdimësi në modernizimin e mësimdhënies, përdorimin e teknologjisë, dhe forcimin e ndihmës për nxënësit me nevoja të veçanta.

Nga analiza e dokumenteve të kontrolluara dhe të dhënave të mbledhura për periudhat 2023/2024 dhe 2024/2025, rezulton se shkolla ka krijuar një sistem të qëndrueshëm dhe funksional për ndjekjen, mbështetjen dhe vlerësimin e arritjeve të nxënësve. Vlerësimi është i bazuar në qasje të gjithanshme, duke përfshirë monitorimin sistematik të suksesit sipas klasave, gjinive, lëndëve dhe grupeve gjuhësore.

Përveç arritjeve në mësim, shkolla promovon pjesëmarrjen e nxënësve në gara, aktivitete kulturore, artistike dhe shkencore, duke ofruar mundësi të barabarta për zhvillim personal dhe akademik. Puna e ekipit profesional, përfshirja e prindërve dhe angazhimi i strukturave si Parlamenti i Nxënësve kontribuojnë ndjeshëm në një klimë pozitive mësimore.

Ekipi për vetevaluim: Të arriturat e nxënësve

1. Adelina Memedi – arsimtare e Gjuhës angleze

2. Besmira Z. Amiri- bibliotekiste

3. Valdet Iseni- arsimtare e Gjuhës angleze

4. Nurten Aliti- mësuese

5. Reshat Jashari- arsimtar i Gjuhës shqipe

6. Emine Amiri- arsimtare e Gjuhës angleze

7. Arjeta Rustemi- arsimtare e Kimisë





FUSHA 3. KLIMA NË SHKOLLË DHË MARRËDHËNIET NË SHKOLLË

Ndarjet në kuadër të fushës:

Klima shkollore

- Reputacioni/imazhi i shkollës
- Kodi i sjelljes;
- Klima shkollore
- Sjellja dhe disiplina në shkollë
- Pjesëmarrja e nxënësve në vendimmarrje dhe zgjidhjen e problemeve

Barazia dhe drejtësia

- Njohja dhe respektimi i të drejtave të fëmijëve
- Trajtimi i barabartë dhe i drejtë i të gjithë nxënësve

Marrëdhënia e partneritetit me bashkësinë

- Bashkëpunimi i shkollës me prindërit/kujdestarët

- Bashkëpunimi me komunën dhe bashkësinë urbane

Kujdesi i përgjithshëm përnxënësit

- Parandalimi dhe mbrojtja nga dhuna
- Mbrojtja nga pirja e duhanit, alkoolit dhe nga droga
- Kualiteti i ushqimit të arritshëm
- Higjiena dhe mbrojtja nga sëmundjet
- Kujdesi për sigurinë e nxënësve dhe të punësuarve
- Kujdesi për nxënësit nga familjet e rrezikuara sociale
- Kujdesi për nxënësit me probleme shëndetësore
- Kujdesi për mirëqenien socio-emocionale të nxënësve
- Dhënia e ndihmës gjatë përzgjedhjes për vazhdimin e arsimit

Klima shkollore

Reputacioni/imazhi i shkollës

Shkolla fillore "Asdreni" në Glllogjë gëzon një reputacion të shkëlqyer në komunitet. E njohur për përkushtimin ndaj cilësisë së arsimit dhe vlerave të shëndosha, ajo është simbol i edukimit dhe përparimit. Prindërit, nxënësit dhe mësimdhënësit e shohin si një institucion model që frymëzon besim dhe respekt të ndërsjellë.

Kodi i sjelljes

Në shkollën “Asdreni”, kodi i sjelljes është i qartë, gjithëpërfshirës dhe zbatohet me përkushtim. Ai promovon respektin, mirëkuptimin dhe përgjegjësinë, duke ndihmuar nxënësit të zhvillojnë vlera të forta morale. Mësimdhënësit dhe nxënësit punojnë së bashku për të krijuar një mjedis të sigurt dhe të drejtë për të gjithë.

Klima në shkollë

Klima në shkollën fillore “Asdreni” është ngrohtë, miqësore dhe inkurajuese. Raportet mes mësimdhënësve dhe nxënësve ndërtohen mbi respektin dhe bashkëpunimin. Mjedisi i përgjithshëm i shkollës ndihmon në zhvillimin e vetëbesimit, motivimit dhe ndjenjës së përkatësisë, duke bërë që çdo nxënës të ndihet i vlerësuar dhe i mbështetur.

Sjellja dhe disiplina në shkollë

Sjellja e nxënësve në shkollën “Asdreni” është për t’u admiruar. Disiplina bazohet në parime edukative dhe ndihmon në ndërtimin e një mjedisi të qetë e të organizuar. Mësuesit ndërtojnë autoritet përmes respektit dhe dialogut, duke nxitur vetëkontroll dhe përgjegjësi personale tek nxënësit.

Pjesëmarrja e nxënësve në vendimmarrje dhe zgjidhjen e problemeve

Në shkollën “Asdreni” nxënësit kanë rol aktiv në jetën shkollore. Ata inkurajohen të shprehin mendimet e tyre, të marrin pjesë në vendimmarrje dhe të japin zgjidhje për çështjet që i prekin. Kjo qasje demokratike forcon ndjenjën e përgjegjësisë dhe përgatit nxënësit për të qenë qytetarë aktivë e të vetëdijshëm.

Barazia dhe drejtësia

Njohja dhe respektimi i të drejtave të fëmijëve

Në shkollën fillore “Asdreni” në Gllogjë, respektohen dhe promovohen në mënyrë të vazhdueshme të drejtat e fëmijëve. Mësimdhënësit janë të ndërgjegjshëm për rëndësinë e **Konventës për të Drejtat e Fëmijës** dhe e integrojnë atë në jetën shkollore. Fëmijët ndihen të dëgjuar, të sigurt dhe të përfshirë në vendimmarrje që i prekin. Shkolla organizon aktivitete ndërgjegjësuere që i mësojnë nxënësit për të drejtat e tyre dhe për respektin ndaj të tjerëve. Kjo qasje nxit një kulturë gjithëpërfshirjeje, ku çdo fëmijë ka zë dhe hapësirë për të shprehur veten pa frikë apo paragjykim.

Trajtimi i barabartë dhe i drejtë i të gjithë nxënësve

Shkolla “Asdreni” promovon në mënyrë të qëndrueshme barazinë dhe drejtësinë për të gjithë nxënësit, pa dallim gjinie, prejardhjeje apo mundësish individuale. Mësimdhënësit punojnë me përkushtim për të siguruar një qasje të drejtë ndaj çdo nxënësi, duke ofruar mbështetje të personalizuar sipas nevojave të tyre (**Plani Individual i Arsimit - PIA**). Asnjë fëmijë nuk mbetet pas apo ndihet i përjashtuar. Aktivitetet mësimore dhe jashtëmësimore organizohen në mënyrë gjithëpërfshirëse, duke forcuar ndjenjën e përkatësisë dhe respektit të ndërsjellë. Kjo përkushtim ndaj trajtimit të drejtë dhe të barabartë ndërton një komunitet shkollor të bashkuar dhe të drejtë.

Marrëdhënia e partneritetit me bashkësinë

Bashkëpunimi i shkollës me prindërit/kujdestarët

Shkolla fillore “Asdreni” në Gllogjë kultivon një marrëdhënie të ngushtë dhe të qëndrueshme me prindërit dhe kujdestarët. Ata shihen si partnerë të rëndësishëm në procesin arsimor dhe ftohen rregullisht në takime, punëtori e aktivitete shkollore. Komunikimi është i hapur, i ndërsjellë dhe i respektueshëm, gjë që ndihmon në identifikimin dhe zgjidhjen e problemeve në kohë. Prindërit inkurajohen të japin mendimet dhe sugjerimet e tyre për përmirësimin e jetës shkollore. Kjo atmosferë e bashkëpunimit forcon lidhjen shkollë-familje dhe krijon kushte më të mira për zhvillimin e gjithanshëm të nxënësve.

Bashkëpunimi me komunën dhe bashkësinë urbane

Shkolla “Asdreni” ka ndërtuar një bashkëpunim të frytshëm me komunën e Tearcës dhe bashkësinë lokale të Gllogjës dhe të Përshëfcës. Institucionet lokale tregojnë përkrahje të vazhdueshme për nevojat arsimore, përmes investimeve në infrastrukturë, pajisje mësimore dhe mbështetje për projekte edukative. Bashkësia përfshihet në jetën shkollore përmes pjesëmarrjes në aktivitete kulturore, ditë të hapura dhe iniciativa vullnetare. Ky partneritet i fortë kontribuon në ndërtimin e një ambienti më të pasur edukativ, ku shkolla bëhet qendër komunitare e zhvillimit dhe mirëqenies për fëmijët dhe familjet e zonës. Shembuj konkretë të këtij bashkëpunimi:

1. Donacione individuale financiare për blerjen e mjeteve shkollore për nxënës;
2. Donacion individual për pajisjen e nxënësve me uniforma shkollore;
3. Sponsorizim nga një person për abonim njëvjeçar për një revistë;
4. Sponsorizim (nga i njëti person) për t’i siguruar nxënist për një afat njëvjeçar.
5. Kabineti i shkencave – i pajisur dhe i rregulluar si rezultat i fitimit të një projekti nga MASH
6. Izolimi i jashtëm i shkollës – projekt i fituar në MASH.
7. Pajisja me 2 tabela smart.
8. Renovimi i sallës.

Kujdesi i përgjithshëm për nxënësit

Parandalimi dhe mbrojtja nga dhuna

Në shkollën “Asdreni” mbizotëron një kulturë paqeje dhe mirëkuptimi. Zbatohen masa të qarta për parandalimin e dhunës dhe promovimin e respektit ndërmjet nxënësve. Mësimdhënësit janë të trajnuar për të identifikuar dhe trajtuar raste të mundshme në mënyrë të menjëhershme dhe me profesionalizëm.

Mbrojtja nga pirja e duhanit, alkoolit dhe nga droga

Shkolla organizon fushata ndërgjegjësuere dhe ligjërata edukative për rreziqet që lidhen me duhanin, alkoolin dhe substancat narkotike. Mësuesit dhe bashkëpunëtorët shëndetësorë luajnë rol aktiv në edukimin e nxënësve për një jetë të shëndetshme dhe larg zakoneve të dëmshme.

Kualiteti i ushqimit të arritshëm

Në shkollën “Asdreni” i kushtohet rëndësi ushqimit të shëndetshëm për nxënësit. Ofruesit e produkteve sigurojnë cilësi dhe kontroll të rreptë mbi ushqimin. Në shkollë promovohet kultura e ushqyerjes së shëndetshme përmes edukimit shëndetësor, ndërsa nxënësit inkurajohen të zgjedhin vakte ushqyese dhe të balancuara.

Higjiena dhe mbrojtja nga sëmundjet

Shkolla është e pajisur me kushte të mira higjienike, dhe higjiena personale promovohet në mënyrë të vazhdueshme. Udhëzimet për larjen e duarve, mirëmbajtjen e hapësirave dhe kujdesin personal përçohen përmes aktiviteteve edukative, duke kontribuar në mbrojtjen nga sëmundjet infektive.

Kujdesi për sigurinë e nxënësve dhe të punësuarve

Siguria është prioritet në shkollën “Asdreni”. Institucioni është i pajisur me plan evakuimi, procedura emergjente dhe mbikëqyrje gjatë pushimeve. Personeli është i ndërgjegjësuar për rëndësinë e një ambienti të sigurt për mësimdhënie dhe punë të qetë. Oborri është i rrethuar me rrjet metali për të ofruar siguri maksimale për fëmijët.

Kujdesi për nxënësit nga familjet e rrezikuara sociale

Shkolla u ofron mbështetje të veçantë nxënësve që vijnë nga familje me vështirësi sociale. Në bashkëpunim me institucione përkatëse, ofrohet ndihmë psikologjike, materiale dhe emocionale, duke siguruar që këta fëmijë të ndihen të përfshirë dhe të mbrojtur në procesin edukativ.

Kujdesi për nxënësit me probleme shëndetësore

Nxënësit me probleme shëndetësore trajtohen me vëmendje dhe kujdes të veçantë. Mësimdhënësit janë të informuar për nevojat e tyre dhe shkolla bashkëpunon me prindërit dhe mjekët për të siguruar mbështetjen e nevojshme në ambientin mësimor. Shkolla ka siguruar dy asistentë personalë për dy fëmijë me nevoja të veçanta arsimore.

Kujdesi për mirëqenien socio-emocionale të nxënësve

Shkolla “Asdreni” i kushton rëndësi të veçantë shëndetit emocional të nxënësve. Atmosfera pozitive, mbështetja nga mësuesit dhe angazhimi në aktivitete sociale ndihmojnë në ndërtimin e vetëbesimit dhe mirëqenies së tyre. Shkolla mirëpret aktorë dhe grupe artistike për të performuar shfaqjet e tyre në funksion të argëtimit të fëmijëve (babadimri, shfaqje me kukulla, stand up komedi). Nxënësit ndihen të respektuar, të pranuar dhe të sigurt emocionalisht.

Dhënia e ndihmës gjatë përzgjedhjes për vazhdimin e arsimit

Mësuesit në bashkëpunim me servisin profesional të shkollës “Asdreni” ndihmojnë nxënësit në përzgjedhjen e rrugës së tyre arsimore me këshillime dhe orientime profesionale. Nxënësit njoftohen për mundësitë e mëtejshme arsimore dhe motivohen të ndjekin interesat e tyre me vetëbesim dhe vizion të qartë për të ardhmen.

Hulumtimi i perceptimeve të mësimdhënësve, nxënësve dhe prindërve mbi klimën në shkollë

Marrëdhëniet midis nxënësve dhe mësimdhënësve bazohen në respekt të ndërsjellë. Ekziston një klimë e hapjes dhe mbështetjes së ndërsjellë, duke inkurajuar zhvillimin e aftësive intelektuale, emocionale dhe praktike, pra aftësitë individuale të të gjithë nxënësve.

Ekziston gjithashtu një marrëdhënie respekti dhe besimi reciprok midis nxënësive në bazë të gjinisë, etnitetit dhe nxënësve me nevoja të veçanta. Shkolla ka etabluar dhe kultivon një kulturë pozitive, komunikim të hapur dhe zgjidhjen konstruktive të problemeve. Në shkollë, vetëm një numër i vogël nxënësish shfaqin sjellje negative siç janë shkelja e rregullave të sjelljes ndaj nxënësive të tjerë dhe mësimdhënësve, dëmtimi i inventarit shkollor dhe mosrespektimi i rregullave të shkollës. Këto fenomene negative kanë fare pak ndikim te nxënësit e tjerë. Me këta nxënës punohet dhe u jepen këshilla nga shërbimet profesionale për t'i kapërcyer ato. Në varësi të seriozitetit të problemit, kërkohet ndihmë edhe nga

prindi. Për promovimin e veprimtarisë arsimore dhe kushteve të punës, shkolla bashkëpunon me Ministrinë e arsimit dhe shkencës, Byronë për zhvillim e arsimit, vetëqeverisjen lokale, prindërit (kujdestarët) e nxënësve, OJQ-të etj.

Misioni i shkollës është që të gjithë nxënësit të kenë mundësi të barabartë për të mësuar dhe përparuar. Ekziston një klimë pozitive për punën, mirëkuptim me njëri-tjetrin, respekt, mësimdhënie cilësore dhe rezultate solide të arritura.

Realizimi dhe kultivimi i interesave dhe aftësive individuale të të gjithë nxënësve, pavarësisht nga gjinia dhe përkatësia etnike bëhet përmes përfshirjes së tyre në aktivitete jashtëshkollore që inkurajojnë dhe kultivojnë tek fëmijët kureshtjen, krijimtarinë dhe aftësitë e tyre njohëse.

Mësimi shtesë është një mundësi për të zgjeruar njohuritë e nxënësve të cilët tregojnë interes të veçantë dhe tregojnë prirje të dallueshme pas mësimdhënies individuale. Me përfshirjen e nxënësve në gara arrihet fryma konkurruese dhe rezultate më të mira arsimore.

Ndihma që shkolla u jep mësimdhënësve për trajtim të barabartë të të gjithëve nxënësve konsiston në:

- punën këshilluese-konsultative në lidhje me përzgjedhjen dhe zbatimin e formave, metodave, mjeteve dhe procedurave efektive në punën mësimore;
- pjesëmarrja në krijimin e një klime të favorshme shoqërore në klasa;
- vendosja e marrëdhënieve demokratike në kolektiv dhe
- pjesëmarrja në zbulimin e ndryshimeve në sjellje.

Në mënyrë që nxënësit të marrin trajtim të barabartë, shkolla monitoron performancën, organizimin e mësimdhënies, punën e aktiviteteve jashtëshkollore si dhe kushtet sociokulturore në të cilat punojnë nxënësit.

Si burime të të dhënave mbi indikatorin e barazisë dhe rregullshmërisë janë shfrytëzuar:


- Procesverbale të mbledhjeve prindore, planifikimet vjetore nga lëndët Histori dhe Shoqëri, Shkathësi jetësor, Arsimi muzikor, Arsimi qytetar;
- Programi vjetor i punës së shkollës, evidenca pedagogjike dhe dokumentacioni lidhur me përfshirjen e nxënësve në aktivitetet jashtëmësimore;
- Raporti vjetor i punës së shkollës;

– Anketë për nxënës

Përveç kësaj, barazia dhe rregullshmëria u vlerësua edhe nëpërmjet anketës me nxënës. Rezultatet nga anketa janë paraqitur në tabelën dhe gravikun në vijim.

Tabela 1. Perceptimet e nxënësve mbi barazinë dhe rregullshmërinë

Pohimi	Po	Jo	Nuk e di
Nxënësit i çmojnë dhe i praktikojnë të drejtat e tyre duke i respektuar edhe të drejtat e të tjerëve	28	3	5
Të gjithë të punësuarit në shkollë janë të njohur me të drejtat e fëmijëve dhe dinë se si t'i respektojnë në praktikë	28	1	7
Shkolla i njofton edhe prindërit lidhur me të drejtat dhe obligimet e fëmijëve	29	2	5
Nëpërmjet mësimit dhe aktiviteteve jashtëmësimore nxënësit mësojnë ta respektojnë traditën dhe kulturën e vetë si dhe traditën dhe kulturën e bashkësive të tjera etnike	30	3	3
Shkolla planifikon dhe realizon aktivitete të përbashkëta mësimore dhe jashtëmësimore me grupe të përziera, me një shkollë partnere në të cilën mësimi zhvillohet në një gjuhë tjetër	35	0	1



Grafiku 1. Perceptimet e nxënësve mbi barazinë dhe rregullshmërinë

Siç mund të vërehet nga tabela 1 dhe grafiku 1, nxënësit në përqindje të lartë prej 77.80% janë shprehur se i çmojnë dhe i praktikojnë të drejtat e tyre duke i respektuar edhe të drejtat e të tjerëve. Mbi 77% e nxënësve pohojnë se të gjithë të punësuarit në shkollë janë të njohur me të drejtat e fëmijëve dhe dinë se si t'i respektojnë në praktikë. Shkolla i njofton edhe prindërit lidhur me të drejtat dhe obligimet e fëmijëve me ç'rast në favor të këtij pohimi janë deklaruar madje 80.60% e nxënësve të anketuar. Rreth 83% të nxënësve pohojnë se nëpërmjet mësimi dhe aktiviteteve jashtëmësimore nxënësit mësojnë ta respektojnë traditën dhe kulturën e vetë si dhe traditën dhe kulturën e bashkësive të tjera etnike. Madje 97.20% e nxënësve të anketuar janë deklaruar se shkolla planifikon dhe realizon aktivitete të përbashkëta mësimore dhe jashtëmësimore me grupe të përziera, me një shkollë partnere në të cilën mësimi zhvillohet në një gjuhë tjetër. Nga rezultatet e paraqitura mund të përfundohet se shkolla ka arritur nivel shumë të lartë të barazisë dhe rregullshmërisë së nxënësve.

Bashkpunimi me prindërit dhe vetëqeverisjen lokale

Bashkëpunimi i shkollës me familjen realizohet përmes formave të ndryshme dhe aktivitete të tilla si:

- kontakte individuale (vizitë e prindit në shkollë, biseda telefonike, komunikim nëpërmjet e mailit, komunikim nëpërmjet aplikacioneve MS Teams, Zoom, Classroom, Edmondo, Viber);
- takimet e prindërve (në shkollë, klasë, grup);
- përfshirja e prindërve në të gjitha fushat strukturore, d.m.th. profesioni dhe afiniteti i tyre kontribuojnë me mendimet dhe sugjerimet e tyre në monitorimin dhe promovimin e veprimtarisë arsimore të shkollës.

Përmes punës së Këshillit të Prindërve ata njihen me Programin Vjetor për punën e shkollës, me raportin e detyrave të realizuara dhe të arriturave, rezultatet, me kushtet e punës, misionin, vizionin për zhvillimin e mëtejshëm.

Shkolla pasuron veprimtarinë e saj arsimore përmes bashkëpunimit me institucionet siç janë: Komuna e Tearcës dhe qeverisja lokale, Policia lokale, Universiteti i Tetovës, Universiteti i Evropës Juglindore, Teatri i Tetovës, Biblioteka e qytetit, me të cilat zhvillon një partneritet në fushën e perfeksionimit të kompetencave të mësimitdhënësve në disa fusha si dhe në edukimin e nxënësve për performansë sa më të mirë praktike.

Shkolla e pranon përkrahjen e prindërve të cilët me vetëiniciativë duan të kyçen në jetën dhe punën e shkollës. Shkolla i inkurajon prindërit që të përfshihen në punën e saj në kuadër të niveleve formale të vendimmarrjes (Këshilli i prindërve, mbledhjet prindore dhe Këshilli i shkollës). Komunikimi i shkollës me prindërit realizohet sipas rregullit të etabluar me së paku dy mbledhje prindore për një gjysmëvjetor, ndërsa rregullisht mbahen edhe takime individuale me prindër. Prindërit ndjehen të mirëseardhur në shkollë.

Bashkëpunimi me bashkësinë lokale realizohet përmes organizimit të aktiviteteve të ndryshme shoqërore kulturore dhe arsimore të tilla si festimet e festave dhe përvjetorët, ekspozitat, mbledhja e sendeve nga pasuria etnografike në mjedisin lokal dhe pasurimin e koleksionit

etnologjik në shkollë si dhe përmes përfshirjes në projekte për të përmirësuar punën e shkollës. Ky bashkëpunim ka rezultuar me rezultate konkrete në pajisjen e shkollës me laptopë për çdo klasë duke ngritur në nivelet më të larta kushtet teknike të mësimdhënies online.

Shkolla është e përfshirë në mënyrë aktive në jetën e komunitetit nëpërmjet zbatimit të projekteve të përbashkëta si dhe organizimit dhe pjesëmarrjes në ngjarje me interes për komunitetin. Shkolla promovon përfshirjen volontere të nxënësve në aktivitetet e komunitetit. Komuniteti përfshihet në përmirësimin e kushteve të punës së shkollës. Shkolla promovon dhe pranon volonterë nga komuniteti në aktivitetet mësimore dhe jashtëmësimore. Shkolla realizon bashkëpunim cilësor me komunitetin e biznesit. Ekzistojnë disa shembuj konkretë të bashkëpunimit të suksesshëm dhe pjesëmarrjes aktive të stafit të shkollës dhe mësimdhënësve në projekte me interes për shkollën. Shkolla bashkëpunon edhe me sektorin joqeveritar. Ekzistojnë praktika të mira në punën e deritashme të cilat i vlerësojmë si jashtëzakonisht të rëndësishme.

Bashkëpunimi i shkollës me komunitetin ka rezultate të shumta në arsim, si: rritet efektshëria e shkollës, rritet cilësia në mësimdhënie, qeverisje funksionale, rezultate të larta në nxënie, aftësimi i njerëzve për punë dhe profesione, rritet standardi ekonomik e jetësor. Inkurajohen vlerat humane për shkathtësi jetësore e sidomos për nxënie gjatë gjithë jetës. Shkolla bashkëpunon me shkollat e tjera në komunë përmes organizimeve të aktiviteteve sportive, lexime letrare, gara dhe të tjera manifestime.

Analiza e rezultateve

Lidhur me vetëevaluimin e shkollës, stafi i shkollës ka realizuar një hulumtim mbi performansën e shkollës në 4 fusha:

1. FUSHA I: PLANIFIKIMI, MËSIMI DHE NXËNIA;
2. FUSHA II: ARRITJET E NXËNËSVE;
3. FUSHA III: KLIMA SHKOLLORE DHE MARRËDHËNIET NË SHKOLLË;
4. FUSHA IV: DREJTIM, UDHËHEQJE DHE HARTIM I POLITIKAVE;

Hulumtimi është realizuar nëpërmjet teknikës së anketimit duke aplikuar një pyetësor të strukturuar për të gjitha fushat. Pyetësori është krijuar në programin google forms dhe është dizajnuar për t'u përfunduar onlajn në kohëzgjatje jo më shumë se 15 minuta. Këtu janë paraqitur

rezultatet e hulumtimit mbi fushën II: Klima në shkollë. Lidhur me këtë fushë janë anketuar 19 mësime, nga të cilët 11 femra dhe 8 meshkuj.

Tabela 2. Struktura e respondentëve sipas gjinisë


Gjinia	N (19)	%
Femra	11	57.89%
Meshkuj	8	42.10%

Pyetja e parë në këtë fushë ishte: Sa jeni të kënaqur me kushtet në shkollë?

Rezultatet janë paraqitur në tabelën nr. 3.

Tabela 3. Niveli i kënaqshmërisë me kushtet në shkollë

Sa jeni të kënaqur me kushtet në shkollë?		
Shumë	15	78.94%
Pak	3	15.78%
Aspak	1	5.26%




Grafiku 2. Niveli i kënaqshmërisë me kushtet në shkollë

Rezultatet e paraqitura në tabelën 3 dhe grafikun 2 tregojnë se shumica e mësimeve apo 78.94% e tyre janë shumë të kënaqur me kushtet në shkollë. Vetëm 15.78% e mësimeve janë pak të kënaqur dhe një përqindje shumë e vogël prej 5.26% e tyre janë shprehur të jenë aspak të kënaqur me kushtet në shkollë. Rezultatet e fituara nga mësimeve janë një përfundim i qartë se ata punojnë në kushte të mira teknike.

Në këtë fushë të evaluimit, në hulumtim janë përfshirë edhe prindërit. Në këtë hulumtim kanë marrë pjesë 30 prindër. Prindërit janë përgjigjur në pyetjen: A jeni të kënaqur me menaxhimin e punëve të shkollës? Rezultatet janë paraqitur në tabelën 4 dhe grafikun 3.

Tabela 4. Niveli i kënaqshmërisë me menaxhimin e shkollës

Sa jeni të kënaqur me menaxhimin e punëve të shkollës?		
Shumë	25	83.33%
Pak	3	10.0%
Aspak	2	6.66%




Grafiku 3. Niveli i kënaqshmërisë me menaxhimin e shkollës

Nga tabela 4 dhe grafiku i saj 3 vërehet se shumica e prindërve apo 83.33% e tyre janë shprehur shumë të kënaqur me menaxhimin e punëve të shkollës, 10% e prindërve janë shprehur pak të kënaqur dhe vetëm 6.66% e tyre janë shprehur të jenë aspak të kënaqur me menaxhimin e punëve të shkollës. Këto rezultate çojnë në përfundimin se shkolla është menaxhuar me profesionizëm dhe që ky menaxhim merr vlerësim të lartë nga prindërit.

Në evaluimin e klimës në shkollë, përmes pyetësorit onlajn, janë përfshirë edhe nxënësit. Pyetësori është dizajnuar të vlerësojë perceptimet e nxënësve lidhur me marrëdhëniet mesimdhënës-nxënës, marrëdhëniet sociale ndërmjet nxënësve, kënaqshmërinë e nxënësve nga realizimi i mësimin dhe pjesëmarrjen e nxënësve në vendimarrjen e shkollës. Në hulumtim kanë marrë pjesë 36 nxënës. Rezultatet janë paraqitur në tabelën 4.

Tabela 5. Perceptimet e nxënësve mbi klimën në shkollë

Pohimi	Po	Jo	Nuk e di
Marrëdhëniet midis nxënësve dhe mësimeve bazohen në respekt të ndërsjellë.	29	3	4
Ekziston besimi midis nxënësve, bashkëpunimi, shoqërimi dhe komunikimi.	30	4	2
Në shkollë ndjehem i/e sigurt, jam i/e kënaqur me mësimin që realizohet në të.	25	4	7
Mësuesit përpiqen të më kuptojnë, ata e respektojnë mendimin dhe idetë e mia dhe dinë t'i zgjidhin problemet.	26	7	3
Nxënësit përmes përfaqësuesve të tyre marrin pjesë në sjelljen e vendimeve të rëndësishme për shkollën.	26	5	5



Grafiku 4. Perceptimet e nxënësve mbi klimën në shkollë

Rezultatet e hulumtimit treguan se shumica e nxënësve apo 80.60% e tyre vlerësojnë se marrëdhëniet midis nxënësve dhe mësimeve bazohen në respekt të ndërsjellë. Një përqindje shumë e lartë prej 83.30% e nxënësve pohojnë se ekziston besimi midis nxënësve, bashkëpunimi, shoqërimi dhe komunikimi. Rreth 70% e nxënësve janë shprehur se në shkollë ndjehen të sigurt dhe se janë kënaqur me mësimin që realizohet në

shkollë. Gjithashtu, një përqindje shumë e lartë e nxënësve që arrin në 72.20% janë deklaruar se mësimdhënësit përpiqen ta kuptojnë nxënësin dhe që mësimdhënësit e respektojnë mendimin dhe idetë e nxënësit dhe dinë t'i zgjidhin problemet. Mbi dy të tretat e nxënësve apo 72.20% e tyre janë deklaruar se nxënësit përmes përfaqësuesve të tyre marrin pjesë në sjelljen e vendimeve të rëndësishme për shkollën. Rezultatet e këtilla çojnë në përfundimin se shkolla ka krijuar marrëdhënie të qëndrueshme mësimdhënës-nxënës, marrëdhënie sociale ndërmjet nxënësve, nivel të lartë të kënaqësisë së nxënësve nga realizimi i mësimin në shkollë dhe përfshirje të mirë të nxënësve në vendimmarrjen e shkollës.

Anët e forta

- Shkolla ka kritere për vlerësimin e nxënësve.
- Shkolla e analizon dhe e respekton diversitetin etnik, kulturor dhe religjioz në shkollë.
- Shkolla në mënyrë sistematike e përcjell, e krahason dhe e analizon gjendjen me suksesin dhe arritjet e nxënësve.
- Shkolla posedon të dhënat lidhur me arritjet e nxënësve sipas gjinisë dhe përkatësisë etnike.
- Prindërit lajmërohen në kohë lidhur me arritjet e nxënësve.
- Bashkëpunim i ndërsjellë ndërmjet shkollës dhe MASH, BZHA, qeverisjes lokale.
- Nxënësit me aftësi të veçanta, gjini dhe prejardhje etnike respektohen reciprokisht, bashkëpunojnë dhe ndihmojnë njëri-tjetrin.
- Ekziston një mbështetje e ndërsjellë dhe një klimë e hapjes për bashkëpunim midis nxënësive dhe mësimdhënësve.
- Shkolla kapërcen me sukses problemet që lidhen me disiplinën dhe sjelljen e nxënësve.
- Shkolla ka përgatitur një Kod të Sjelljes për mësimdhënësit dhe nxënësit.
- Hapja maksimale e shkollës për bashkëpunim me prindërit dhe bashkësinë lokale.

Anët e dobëta

Pjesëmarrja e prindërve të nxënësve me sjellje problematike dhe të atyre me arritje të dobëta në mbledhjet e prindërve dhe në takimet individuale, nuk është e kënaqshme.

Ekipi i evaluimit: Klima në shkollë

1. Shpresa Adili
2. Mamudije Zeqiri
3. Habibe Vejseli
4. Zurafete Eshtrefi
5. Besim Elmazi
6. Nehad Jonuzi

FUSHA 4. DREJTIM, UDHËHEQJE DHE HARTIM I POLITIKAVE

Ndarja në kuadër të temës:

4.1 Drejtimi dhe udhëheqja e shkollës

4.2 Qëllimi dhe hartimi i politikës shkollore



Tëdhënat e mbledhura	
Dokumentacioni i kontrolluar-Burimet	Informatat e mbledhura
4.1 Drejtimi dhe udhëheqja e shkollës Temat: - Drejtimi i shkollës - Udhëheqja e shkollës - Drejtimi dhe udhëheqja e burimeve - Udhëheqja e kuadrit - Ndjekja dhe avancimi i procesit mësimor	➤ Struktura e organit drejtues në shkollë është e definuar me ligj, ku udhëheqës është drejtori i shkollës me ndihmën e sekretarit, pedagoges dhe psikologes së shkollës. ➤ Përgjegjësitë janë të definuara në mënyrë të qartë sipas rregullave të shkollës. ➤ Udhëheqësia e shkollës deri diku bashkëpunon me aktivet e tjera nëpërmjet mbledhjeve dhe takimeve individuale. ➤ Shkolla jonë është e pavarur dhe nuk ka shkolla periferike. ➤ Këshilli i shkolles i cili është i konstruktuar në pajtim me rregulloren e shkollës si dhe statusin. ➤ Kshilli i shkollës është i përbër prej 7 anëtarve si vijon: 3 përfaqësues të mësimdhënësve (bashkpuntorë profesional, edukator special) 3 përfaqësues nga prinderit 1 anëtar nga kuvendi komunal Në mbledhjet e keshillit shkolllorë ftohen edhe në punën e vet marrin pjesë, pa të drejtë votimi edhe dy përfaqësues të nxënësve të zgjedhur nga parlamenti i nxënësve. ➤ Këshilli i shkollës është i obliguar të menaxhoj dhe të ndjek

	politikën në shkollë. ➤ Këshilli i shkollës bën verifikimet e statusit të shkollës, planin financiar, hapjen e konkurseve, pranimet, propozimet e puntorëve të rinj si dhe pranimet e drejtorëve të shkollës. ➤ Këshilli i shkollës mban mbledhje me shumicën e anëtarëve të vet. ➤ Ekipet e shkollës takohen në bazë të nevojave të shkollës. Përgjegjës për pjesëmarrje është drejtori i shkollës. ➤ Marrëdhëni ndërmjet ekipit udhëheqës me subjektet tjerë në shkollë janë të shkëlqyer dhe ato informohen në bazë të mbledhjeve, lajmërimeve etj.
	Organi udhëheqës i shkollës ka njohuri se në çfarë mënyre objektivisht t’i vlersojë cilësitë e të punësuarve dhe kontributin e tyre në punën ekipore dhe si ta promovojë praktikën e mirë që ekziston në shkollë. Sjellë vendime përgjegjëse, merrë iniciativa dhe menaxhon suksesshëm me ndryshimet në sistemin arsimor. Identifikon dhe fokusohet në prioritetet e qarta që janë identifikuar në planin zhvillimor përmes evaulimit personal efektiv, kurse në qendër të punës së vet i vendos arritjet e nxënësve dhe përmirsimin e pasqyrës shkollore. Të gjitha organet në shkollë tone funksionojnë në lidhshmëri me njëra tjetrën siç janë. Drejtori bashkëpunon me këshillin e shkollës dhe pastaj për raste të ndryshme njoftohen arsimtarët nëpërmjet organeve të tyre si ai i kolegiumit dhe këshillit të klasave, ndërsa këta në takime me prindërit në mbledhjet e organizuara prindore i informojnë ata. Prindërit mendimet apo propozimet e tyre i drejtojnë tek këshilli i prindërve. Nxënësit informohen nëpërmjet kujdestarëve të klasave. Rol të posaçëm në zhvillimin e procesit edukativo-arsimor ka edhe bashkëpunimi i drejtorit me shërbimin profesional të shkollës dhe me trupin arsimor, i cili bashkëpunim realizohet me takime

	individuale apo edhe me mbledhjet e organizuara të kolegiumit apo këshillit të klasave. Si drejtori po ashtu edhe shërbimi profesional i shkollës kanë program vjetor për punën e tyre.
Burimet e të dhënave	Rregullorja për punën e këshillit shkollor, Statuti i shkollës, Procesverbalet, vendimet dhe raportet nga këshilli i shkollës, plani zhvillimor.
4.2 Qëllimi dhe hartimi i politikës shkollore	Qëllimet janë precize të qarta që reflektojnë vlera në shkollë. Gjatë përcaktimit të qëllimeve inkuadrohen mësimdhënësit, prindërit, nxënësit dhe përfaqësuesit e bashkësive vendore. ➤ Shkolla jonë ka plane aksionare për qëllime të caktuara. Ka plane për ndjekjen dhe vlersimin e realizmit të aktiviteteve dhe aritjeve

Temat: • Procedurat për hartimin e politikës shkollore • Rezultatet e planifikimit zhvillimor • Planifikimi dhe udhëheqja e buxhetit shkollor Burimet e të dhënave	të caktuara për suksesin e nxënësve. ➤ Shkolla është e obliguar t'i informon mësimezhënësit nxënësit dhe prindërit lidhur me procesin edukativo-arsimorë. Shkolla ka parasysh mendimet e mësimezhënësve prindërve dhe nxënësve. ➤ Shkolla jonë vazhdimisht punon rreth infrastrukturës në shkollë duke siguruar mjete nga burime të ndryshme që të duket si një shkollë me kushte normale për punë. ➤ Shkolla ka nevoj për mjete materiale dhe teknike. ➤ Mjetet gjithmonë janë të konkretizuara dhe të planifikuara për qëllime të caktuara. Ata shfritzohen në mënyr adekuate sipas planifikimeve dhe sasisë së tyre. Ata në shkollën tonë kanë mbykqyrje te mjaftushme , megjithse organet e shkollës të cilët kanë njohuri dhe janë të njohur me mjetet materiale në shkollë . Shkolla jonë vazhdimisht shqyrton disa plane për modernizimin e infrastrukturës së shkollës dhe siguron mjete të veta si dhe mjete nga donatorë të ndryshëm. ➤ Shkolla vazhdimisht tenton të ketë bashkëpunim me vetqeverisjen lokale dhe bashkësit vendore për përmisimin e infrastukturës së shkollës. Nga ana e pjestarëve të policisëmbahen ligjerata me nxënësit e klasave të teta dhe nënta në lidhje me drogën ,alkoholin, dhe duhanin. Sa i përketshëndetit të nxënësve kujdes të veçantë u japin në orët e kujdestarisë shkathtësive jetësore. Arsimtarët njoftohen me aftësitë psiko fizike dhe shëndetsore të nxënësve. Nga ana e arsimtarëve organizohen orë shtuese dhe plotësuese si dhe aktivitete të lira të nxënësve.Shkolla planifikon dhe me kohë mundëson materiale harxhuese në numër të konsiderueshëm për realizimin e mësimit dhe aktiviteteve jashtë mësimore në pajtueshmëri me planin shkollor. Programi vjetor për punën e shkollës,anketat gojore me drejtorin shërbimin
---	---

	profesional , mësimdhënësit, prindërit dhe nxënësit ,procesverbalet nga Këshilli shkollor, Këshilli prindëror, Këshilli arsimor, dhe aktet interne
--	--

Dokumentacioni i kontrolluar-Burimet	Informatat e mbledhura
	Qëllimet janë precize të qarta dhe e reflektojnë misionin dhe vizionin e shkollës. Gjatë përcaktimit të qëllimeve inkuadrohen mësimdhënësit, prindërit nxënësit dhe përfaqësuesit e bashkësisë lokale. Shkolla ka plan për ndjekjen e suksesit të nxënësve që e realizon 4 herë brenda një vitishkollor edhe atë përgatit raporte sa i përket suksesit të nxënësve ,në tremujorshin e parë,në gjysëmvetorin e parë,në tremujorshin e dytë dhe në fund të vitit shkollor me anë të raportit tekstual dhe statistikor.Shkolla i merr parasysh qëndrimet e mësimdhënësve, prindërve dhe këshilltarëve komunal. Nga kjo shihet se shkolla me kohë vazhdimisht i identifikon nevojat për trajnim profesional të kuadrit Në arsimin fillor në periudhën e kaluar është bërë një përparim i madh në kualifikimin e kuadrit arsimor po ashtu edhe në shkollën tonë si në atë të

arsimimit klasor dhe lëndor.

Kuadri arsimor i shkollës mundohen ti përcjellin risitë dhe ndryshimet në të gjitha fushat arsimore dhe i praktikojnë në punën e tyre të përditshme përmes seminareve të ndryshme që i organizon Byroja për Zhvillimin e Arsimit si dhe MASH-ës.

E njëjta vlen edhe për drejtorinë dhe shërbimin profesional të shkollës, të cilët çdo here i përcjellin dhe i pranojnë ndryshimet me kujdes i praktikojnë në punët e tyre të përditshme.

Rëndësi të veçantë u kushtohet formave dhe metodave të reja të punës si dhe mësimit interaktiv gjatë orës mësimore që duhet ti përdorin mësimdhënësit në procesin edukativo-arsimor.

Sa i përket projekteve shkolla jonë është e kyqur në Projektin ndëretnik në arsim, çertifikimi i mësimdhënësve trajnimi i mësimdhënësve të lëndëve shkencoro-natyrore.

Nga i gjith ky trajnim profesional i mësimdhënësve lirisht mund të themi se shumica e mësimdhënësve përdorin metoda dhe forma të reja në procesin edukativo-arsimor.

Shkolla jonë ka një numër të konsiderueshme të kompjuterëve,projektorëve dhe printerëve si dhe mjeteve tjera mësimore që ndikojnë pozitivisht në zhvillimin e procesit-edukativoarsimor.

Shkolla i identifikon me kohë nevojat për mjete materiale dhe teknike dhe vazhdimisht i planifikon dhe i siguron ato.

Shkolla planifikon dhe siguron mjete për mirëmbajtjen e vazhdueshme të tyre.Ndodh që shkolla përveç që siguron mjete nga MASH-së, sigurojnë mjete edhe nga donatorë të

ndryshëm si nga ana e prindërve biznesmenëve të ndryshëm

	bashkëpunon me bashkësinë lokale , organizatat e ndryshme qeveritare dhe jo qeveritare dhe prindërit sa i përket përmirsimit të infrastruktures së shkollës. Plani zhvillimor i shkollës,proçesverbalet nga organet dhe trupat shkollore, intervista gojore me drejtorin mësimdhënësit,prindërit nxënësit dhe anëtarët e këshillit të shkollës,plani financiar i shkollës qasje në paisjen dhe infrastrukturën e shkollës.
--	--

Burimet	Kush imblodhi informacionet	Çfarë u konkludua
- Anketë me prindër	Ekip përmbledhjen e të dhënave	❖ Sa jenite kenaqur me menaxhimin e punëve profesionale të shkollës? Shume :75% Pak :25% Aspak : \
- Anketë me prindër	Ekip përmbledhjen e të dhënave nga prindërit	❖ Politika arsimore e kadrovikëve nga dhë e qësia e realizohet mirë. deklarata e prindërve janë PO 75 %, JO 10 % Ndonjëherë 15 %
- Anketë me arsimtar	Ekip përmbledhjen e të dhënave nga arsimtarët	❖ Sa meret para sysh mendimi i arsimtarëve nga dhë e qësia e shkollës? Shumë :70% Pak :30%
- Anketë me arsimtar	Ekip përmbledhjen e të dhënave	❖ Arsimtarët e shkollës nënë jan të interesuar në mësim të shumtipërpërsosjen e tyre profesionale në bazë të seminareve të ndryshme për zhvillim profesional.

- Anketë me nxënës	Ekipi për mbledhjen e të dhënave nga nxënësit	❖ Sa janë të pranueshme kërkesat e nxënësve deri te udhëheqësia? Shumë : 80% Pak : 20% ❖ A janë të realtë mësimi dhe njësiti në vlerësim? Po : 85% Jo : 15%

Analiza e rezultateve

Edhe pse udhëqja është në mënyrën më të mire të mundshme, përsëri mendojmë edhe më mire sitëangazhohen, mëtepërtëkenëbashkëpunimin me arsimtarët, prindëritdhenxënësit.

Pedagogia e shkollës së bashku me psikologën shpesh herë përgatitin pyetësor, teste , anketa për të qenë të njohur me nivelin e njohurive dhe aftësive të nxënësve. Për përmirësimin e kushteve në shkollë udhëheqësia shpesh kërkon donacione nga shoqata të ndryshme joqeveritare, ku disa prej tyre janë edhe realizuar. Në përgjithësi në shkollë gjatë festave organizohen manifestime të ndryshme. Mësimi i gjuhëve të huaja realizohet pa pengesa si në gjuhën angleze, maqedone dhe frënge. Politika arsimore kadrovike nga udhëheqësia realizohet në mënyrë të rregullt. Arsimtarët e shkollës më së shumti janë të interesuar për përgatitjen profesionale të tyre duke ndjekur seminare të ndryshme, orë praktike, kurse etj.

Shkolla vazhdimisht e revidon planin për përmirësimin dhe modernizimin e infrastrukturës së shkollës dhe siguron mjete nga donatorë të ndryshëm dhe komuna. Në shkollën tonë ka klimë për punë dhe bashkëpunimi është në nivel edhe nëbaza etnike dhe fetare.

Anët e forta :

- Udhëheqja e shkollës realizohet në mënyrë të mirë.
- Rregullisht ndiqen risitë në procesin mësimor.
- U jepet përkrahje nxënësve të cilët kanë probleme me procesin mësimor.
- Nxënësit stimulohen nga udhëheqësia e shkollës për sukseset e tyre me mirënjohje.
- Në shkollë organizohen manifestime për çdo festë me rëndësi.
- Aktivitetet profesionale funksionojnë në mënyrë të rregullt.

Anët e dobëta:

- Bahkëpunim më i madh me shkollat tjera fillore nga komuna
- Përfshirja më e madhe e prindërve në punëtoritë dhe projektet shkollore.
- Organizimi i aktiviteteve ekologjike në shkollë dhe në rrethinë.

Prioritetet

- ❖ Me përmirësimin e kushteve nës hqollë do të angazhohemi tëmbajmë mësim në kabinet me mjete për zbatimin e njësive mësimore.
- ❖ Përgatitja profesionale e arsimtarëve me anëtarëseminareve, kurseve dhe mësimi praktik.
- ❖ Mbështetja e nxënësve në kërkesat e tyre dhe nxënësve të cilët kanë vështirësi gjatë procesit arsimor.
- ❖ Aktivitete shtesë për nxënësit me koeficient të lartë të intelegjencës.
- ❖ Angazhimi i nxënësve në projekte të ndryshme

Ekipi për vetevaluim:Drejtir, udhëheqje dhe hartim i politikave

1. SafijeRaufi - arsimtare
2. FitoreReani-arsimtare
3. ElmedinaEsati- arsimtare
- 4.Selim Jonuzi- arsimtarë
5. ArbenIsaku-arsimtarë
6. AltimMuaremi - arsimtarë
7. FikrieAsani – arsimtarë